



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI


Nr./Br. 333/12
Datë/Datum. 26.12.2012

PRISHTINË - PRIËTINA



REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/PROCUREMENT REVIEW BODY

DATË/A:	26.12.2012
REFERENC-Ë:	333/12
PËR/ZA/TO:	OE "Magjistranja" sh.p.k. Gjilan
NGA/OD/FROM:	z. Hysni Hoxha - Kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje ndaj ankesës së datës: 24.12.2012



Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën kundër urdhëresës nr. 333.12 të datës: 17.12.2012 me nr. të protokollit 333/12 me datën: 24.12.2012 të parashtruar nga OE "Magjistranja" sh.p.k. Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve 2012/2013 ne Komunën e Gjilanit- i ndarë në dy Lote" me Nr. të Prokurimit GI615/12/111/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues/ KK Gjilan, në të cilën ceket: kërkojmë të mbetet vendimin i Komunës së Gjilanit i datës: 13.12.2012 të njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli Shqyrtues i OSHP-së me datën: 06.12.2012, ka marrë vendim që të aprovohet si e bazuar ankesa e OE ankues, njëkohësisht e ka urdhëruar AK-së- KK Gjilan që ta anuloj njoftimin mbi dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve 2012/2013 ne Komunën e Gjilanit- i ndarë në dy Lote" , dhe lëndën ta ktheje ne Ri vlerësim.

Autoriteti Kontraktues KK Gjilan përmes parashtrësës së datës 24.12.2012, e ka njoftuar OSHP-në se ju kanë përmbajtur Urdhëresës me nr. 333/12 të datës: 17.12.2012, ku fillimisht ka bërë anulimin e njoftimit për dhënie të kontratës, ndërsa ju nevojiten edhe 2-3 ditë për fazën e rivlerësimit të ofertave.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas shqyrtimit të shkresës së OE "Magjistranja" sh.p.k. Gjilan , me nr. të protokollit 333/12 të datës: 24.12.2012, konstaton se vendimi i Panelit Shqyrtues nr. 333/12 i datës: 06.12.2012, është vendim përfundimtar i formës së prerë. Ndërsa në rastin konkret OE i lartë përmendur nuk ka qenë palë e përfshirë në kontest, megjithatë palët e pakënaqur me vendimin e PSH-së kanë të drejtë të parashtrorj kërkesë- padi në Gjykatën Suprem të Kosovës 30 ditë pas marrjes së vendimit të Panelit Shqyrtues.